

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE KORCE  
NOTERI V.M.  
Nr. UU17 Rep.  
Nr. 811 Kol.



### KONTRATE SHITJE

#### (TRANSFERIM KAPITALI NDERMJET ORTAKEVE)

Sot, me date 12 Tetor te vitit 2001, ditën e Premte, ne ora 22.00 para meje noterit Vladimir Fehmi Molla, anetar i dhomes se notereve Korce, u paraqiten Renato Behar KOCIBELLI, lindur e banues ne Korce, madhor i afte per te kryer veprime juridike, i njohur prej meje. Maksim Vangjel SOTIRI, lindur e banues ne Korce, madhor, i afte per te kryer veprime juridike, i njohur prej meje. Markelian Gezim KUQO, lindur e banues ne Korce, madhor, i afte per te kryer veprime juridike, i njohur prej meje.-----

-----Te tre personat e siperpermendur me kerkuan te perpiloj kete akt me permbajtjen e meposhtme sipas vendimit te perbashket te tyre:-----

-----Me anen e vendimit Nr 25908, date 31.05.2001 kemi formuar nje shoqeri tregtare me emertimin "MRM" Shpk. Si kapital i shoqerise sone e zoteruar ne pjese te ndryshme e te pandara ne pjeset respektive: Renato KOCIBELLI 40%, Maksim SOTIRI 30% dhe Markelian KUQO 30% te veprimtarise televizive "LOBI VIZION" te cilat emertohen si pajisje televizive.-----

-----Pjeset e tyre te pandara mbi kapitalin e shoqerise dy nga ortakët themelues e konkretisht Maksim SOTIRI e Markelian KUQO kane vendosur te shesin (transferojne) tek ortaku tjetër themelues bleres Renato KOCIBELLI, pasi sipas Statutit te shoqerise tregtare "MRM" Shpk transferimi i pjeseve te kapitalit investues se shoqerise tregtare eshte i lejuar midis ortakëve.-----

-----Ortakët me marreveshjen e tyre te lire dhe te padetyruar prej askujt kane vendosur te caktojne si cmim per shitblerjen e te dy pjeseve respektive ne masen 60% te kapitalit shumen prej **3.473.600**-----

(tremilione katerqind e shtatëdhjetë e tremijë e gjatë) Lek, e cila u dha ne dorezim nga ortaku bleres Renato KOCIBELLI dhe u mor ne dorezim nga ortakët shites Maksim SOTIRI e Markelian KUQO, bashkerisht, e gjitha ketu para meje duke u numeruar nje per nje.-----

-----Permbajtja e ketij akti u lexua me ze te larte e te shkoqur nga ana ime si noter dhe si u gjend e perpiluar sipas kerkeses se pjesemarrësve ne akt u nenshkrua prej tyre dhe prej meje noterit.-----

**SHITES (TRANSFERUES TE PJESEVE TE KAPITALIT)**

Maksim SOTIRI

Markelian KUQO

**BLERES:** Renato Behar KOCIBELLI

**NOTER:** VLADIMIR FEHMI MOLLA

